



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 40/08

Prishtinë, më 18.12.2008, ora 15:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Besa Gaxherri, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Shkumbin Demaliaj, Müfera Şinik, Xhevdet Neziraj, Hajdin Abazi, Riza Smaka.

Anëtarët jo të pranishëm: Naser Osmani, Kosara Nikolić.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Tisma-Prica, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Agim Krasniqi Drejtor i Buxhetit në MEF, përfaqësues nga Ambasada e Amerikane, Teki Shala nga NDI, monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. L-105 për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2009**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesi, pas hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. L-105 për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2009**

Kryesuesi, përshëndeti përfaqësuesin e Ambasadës Amerikane për praninë e tij. Njoftoi anëtarët e komisionit se përfaqësuesit e USAID-it kanë bërë disa propozime që lidhen me pjesën tekstuale të Projektligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009. Për më tepër sqarime ia dha fjalën përfaqësuesit të pranishëm.

Përfaqësuesi e Ambasadës Amerikane, z. Xhon, theksoi se Ambasada Amerikane përmes USAID-it mbikëqyr dhe ndihmon punën e Kuvendit të Kosovës. Në këtë drejtim vlerëson bashkëpunim e mirë që ka me Kuvendin. Prandaj më qëllim të ofrimit të ndihmës konkrete edhe me rastin e shqyrtimit dhe miratimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës, theksoi se kemi dy propozime për ndryshimin e pjesës tekstuale të Projektligjit. I pari ka të bëjë fshirjen e paragrafit 10.5 të propozuar nga anëtarët e komisionit, si dhe ndryshimi i dytë ka të bëjë me nenin 16.2, i cili propozohet të riformulohet si vijon: Nëse një ndërmarrje publike ose pjesë e saj që ka përfituar kredi në pajtim me nenin 16.1 nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe që ka vendim për privatizimin, dhënien me koncesion ose formave tjera të partneritetit privat-publik në vitin 2009, atëherë kredia e dhënë ndërmarrjeve të tilla do të përfshihet si pjesë e kontratës dhe do të paguhet (rikthehet) në përputhshmëri me Tabelën 1 të bashkangjitur.

Pas propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Miratohen propozimet për fshirjen e paragrafit 10.5 dhe riformulimin e paragrafit 16.2 të pjesës tekstuale të projektligjit për ndarjet buxhetore për vitin 2009.

Në vazhdim anëtarët shqyrtuan dhe miratuan amendamentet finale të bëra në pjesën tekstuale dhe tabelare në projektligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2009.

Mbledhja përfundoi në ora 17:00

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI